

RREGULLORE E VOTIMIT

1. Votimi bëhet i fshehtë, në një mjedis që garanton fshehtësinë e votës.
 - a) Procesi i votimit do të zhvillohet në datën 18 Dhjetor 2021, ne ambientet e Muzeut Historik në Tiranë, nga ora 10.00 – 17.00.
 - b) Procesi i votimit mbahet në kushtet e respektimit të masave anticovid, duke i dhënë përparësi votimit me prioritet të votuesve, sipas vendndodhjes së tyre gjeografike. (*distancës nga Tirana*).
 - c) Në momentin që një votues paraqitet përpara Komisionit, identifikohet sipas Letërnjoftimit apo Pasaportës. Në Listën e Votuesve bëhet një shenjë dalluese për të identifikuar personin që voton. Pasi pajiset me dy fletë votimi, sipas çdo fushe kandidimi, të nënshkruara nga një anëtar i Komisionit të Zgjedhjeve, votuesi shkon në mjedisin e posaçëm, (dhoma e fshehtë) plotëson fletën e votimit dhe e hedh në kuti.

Si votohet:

- d) Në fletën e votimit për Anëtarët e Këshillit Kombtar të Urdhrit të Punonjësve Socialë, *vendosni njërën nga shenjat +, -, ×; përkrah **9 (nëntë)** emrave që dëshironi të votoni. Çdo shënim tjetër në fletën e votimit, e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i më shumë se **9 (nëntë kutive)** e bën fletën të pavlefshme.*
 - e) Në fletën e votimit për Kryetar të Urdhërit të Punonjësve Socialë, *vendosni njërën nga shenjat +, -, × ; përkrah emrit që dëshironi të votoni. Çdo shënim tjetër në fletën e votimit e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i më shumë se **1 (një)** kutie, e bën fletën të pavlefshme*
 - f) Pas përfundimit të procedurës për çdo votues, pasi deklaron të mbyllur procedurën e votimit, Komisioni i Zgjedhjeve tërhiqet në një mjedis të izoluar për të kryer numërimin. Mjedisin duhet të jetë i hapur për të gjithë që kanë dëshirë të vëzhgojnë, dhe mundësisht i monitoruar me kamera, për ta bërë sa më transparent procesin e numërimit.
2. Në përfundim të procedurës së numërimit të votave, Komisioni Zgjedhor shpall kandidaturat fituese, si më poshtë:
 - a. Për Kryetar të Urdhërit, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse. Subjekti, që ka

mbledhur më shumë vota, shpallet nga Komisioni i Zgjedhjeve, si Kryetar i Urdhrit.

- b. Për anëtarët e Këshillit Kombëtar, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse. 9 Kandidatët që kanë mbledhur më shumë vota shpallen nga Komisioni i Zgjedhjeve, si anëtarë të Këshillit Kombëtar.
3. Komisioni i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për të dokumentuar me procesverbal të gjithë numërimin sa më sipër dhe merr vendim për shpalljen e kandidaturave ftuese, të cilin, bashkë me procesverbalet, si dhe materialet e tjera zgjedhore, ia përcjell Komisionit të Përkohshëm.
4. Çdo ankesë në lidhje me procesin zgjedhor i paraqitet Komisionit të Përkohshëm brenda 3 ditëve nga dita e zgjedhjeve.
5. Komisioni i Përkohshëm, pasi shqyrton edhe ankesat e mundshme të depozituara pranë tij në lidhje me zgjedhjet, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit të ankimeve, konfirmon ligjshmërinë e procesit zgjedhor, shpall Kryetarin e Urdhërit, dhe anëtarët e zgjedhur të Këshillit Drejtues.